

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë
Publike të Kosovës
Departamenti i Epidemiologjisë
Njësi për Sëmundjet Kronike



Kosova National Institute of Public
Health
Department of Epidemiology
Chronic Diseases Unit

Prof. Dr Naser Ramadani

HULUMTIMI GJITHËPËRFSHIRËS I DUHANPIRJES TE TË RINJTË NË KOSOVË

Monografi

Prishtinë, maj 2005

We would like to thank World Health Organization, Office in Prishtina for making it possible to print this publication.

Falënderojmë Organizatën Botërore të Shëndetësisë, Zyra në Prishtinë e cila ka bërë të mundur shtypjen e këtij publikimi.

Shkurtesat

| | |
|--------|--|
| IKSHPK | – Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës |
| IRSHP | – Instituti Rajonal i Shëndetësisë Publike |
| CDC | -Qendrave të SHBA-së për Kontrollim dhe Parandalim të Sëmundjeve |
| CPHA | – Shoqata Kanadeze për Shëndetësi Publike |
| CIDA | - Agjensioni Ndërkombëtar Kanadez për Zhvillim |
| WHO | – World Health Organization |
| OBSH | – Organizata Botërore e Shëndetësisë |
| QMF | – Qendra e Mjekësisë Familiare |
| PMF | – Punkti i Mjekësisë Familiare |
| ShSh | – Shtëpia e Shëndetit |

Ekspertët e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike që kontribuan në këtë hulumtim:

Prof. Dr Naser Ramadani

Prof. Dr Merita Berisha

Ass. Dr Drita Zajmi

Ass. Dr Rina Hoxha

Ass. Dr Ariana Kalaveshi

Dr Luljeta Gashi

Hyrje

Duhani shkakton probleme të rënda shëndetësore. Një në dhjetë vdekje në mbarë botën i atribuohet përdorimit të duhanit.ⁱ Deri në fund të viteve të 1990-a prodhimet e duhanit ishin shkaktarë të 1.2 milion vdekjeve në mbarë botën (14% e të gjitha vdekjeve). Nëse nuk implementohen masa për kontrollimin e duhanpirjes, llogaritet se deri në vitin 2020 duhani do të jetë shkaktar i 2 milion vdekjeve (20 % e të gjitha vdekjeve) në vit. Për shekullin 21 parashikohen rreth 1 miliard vdekje të ndërlidhura me duhanin.ⁱⁱ Rreth 70% e këtyre vdekjeve do të ndodhin në vendet në zhvillim dhe atyre në tranzicion. Shumica e njerëzve fillojnë ta përdorin duhanin para moshës 18 vjeçare. Mbi 30 % e fëmijëve e pinë cigaren e parë para moshës 10 vjeçare. Gjysma e të rinjve që vazhdojnë ta pinë duhanin vdesin nga shkaqe të ndërlidhura me duhaninⁱⁱⁱ.

Rajoni Evropian i OBSH-së (Organizata Botërore e Shëndetësisë), me vetëm 15% të popullatës botërore, ballafaqohet me 1/3 e barrës botërore të sëmundjeve të ndërlidhura me duhanin. Përderisa të dhënat tregojnë për një rënie të prevalencës së përgjithshme të pirjes së duhanit, prej 45% në 30% gjatë 30 viteve të fundit, si dhe stabilizim të saj, prevalenca e pirjes së duhanit në Rajonin Evropian ende mbetet në nivel që është shkatërrues për shëndetësinë publike dhe që ka implikime serioze për gjeneratat e ardhshme.

Trendet negative në prevalencën e pirjes së duhanit në mesin e të rinjve, grave dhe grupeve në pozita të ulëta shoqërore-ekonomike, si dhe dallimet ndërmjet politikave mbi kontrollin e duhanit në mes të shteteve anëtare të OBSH-se, paraqesin një brengë të veçantë. Mungesa e vullnetit politik dhe vazhdueshmërisë së politikave mbi kontrollin e duhanit ende janë karakteristikë e një pjese të madhe të Rajonit Evropian.^{iv}

Ndikimi në shëndet

Pirja e duhanit është faktor i rëndësishëm rreziku për sëmundje kardiovaskulare dhe kancer të mushkërive. Rreziku për kancer të mushkërive të personat që nuk e pinë duhanin por i ekspozohen pirjes së duhanit nga të tjerët (pirja pasive e duhanit) rritet për 20% deri në 30 % dhe rreziku i shtuar për sëmundje të zemrës është 23%.^v Të gjitha toksinat prej tymit të cigareve të cilat arrijnë në gjakun e gruas shtatzënë shkojnë te feta i saj në zhvillim dhe shkaktojnë dëme. Monoksid karboni pengon që feta të marrë oksigjen të mjaftueshëm. Tymi i cigareve përmban kancerogjene të cilat gjithashtu e dëmtojnë materialin gjenetik-ADN në qelizat e placentës dhe ato të fetusit. Si rezultat, pirja e duhanit (dhe ekspozimi ndaj pirjes pasive të duhanit) nga një grua shtatzënë e ngrit rrezikun për defekte në fëmijun e saj dhe gjithashtu e rrit probabilitetin për 1/3 për abort spontan apo lindje të vdekur. Grave të cilat e pinë duhanin, për 3 deri 4 herë më tepër se ato të cilat nuk e pinë duhanin, mund t'ju nevojitet më tepër se një vit të mbeten shtatzënë, 3 herë më tepër të jenë jo-fertile dhe gjithashtu të kenë menopauzë më të hershme. Duhani gjithashtu e ngrit mundësinë e abnormaliteteve në spermën e mashkullit dhe e zvogëlon dendësinë dhe shpejtësinë e spermës. Gjithashtu shkakton impotencë të meshkujt.^{vi}

Duhanpirja pasive ka ndikim të rëndësishëm në shëndet. Llogaritet se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës 3,000 persona të cilët nuk e pinë duhanin vdesin çdo vit nga kanceri i mushkërive dhe gati 300,000 fëmijë kanë infeksione të **traktit respirator** si pasojë e ndjeshmërisë së ngritur pas ekspozimit pasiv të duhanit.^{vii} Rreziku i vdekjes nga sëmundjet koronare të zemrës është i rritur deri në 30% tek ata që i ekspozohen tymit të duhanit në mjedisin shtëpiak dhe në punë.^{viii}

Përdorimi i Duhanit në Kosovë

Prevalenca

Të dhëna të sakta dhe përfaqësuese mbi përdorimin e duhanit nga ana e fëmijëve dhe të rriturve të rinjë në Kosovë nuk janë në dispozicion. Studimet e pilot hulumtimeve përgatitore, të bëra në Kosovë në vitet 2001 dhe 2002, zbuluan se 47.2% e të rinjve të anketuar për herë të parë kishin provuar cigaren para moshës 18 vjeçare.^{ix} Në një studim vështrues të bërë në 9 shkolla të mesme në Kosovë, 18.6% e të anketuarëve ishin duhanpirës (definim që nënkupton pirjen e së paku 10 cigareve gjatë një periudhe prej 24 orësh). Në një studim tjetër të të rinjve në Kosovë, i deleguar nga UNICEF-i në Kosovë, 49% e të anketuarve pohonin se ishin duhanpirës, me prevalencë të pirjes mbi 24% në mesin e atyre në moshën 18-24 vjeçare. Në mesin e duhanpirësve të tanishëm, 1/3 kishin pirë duhan javën para studimit dhe mbi 3/4 e tyre kishin pirë duhan dikur gjatë 30 ditëve paraprake, mesatarisht 11 cigare në ditë.^x

Legjislacioni

Në Kosovë janë dy ligje ekzistuese dhe një projekt ligj i cili pritet të miratohet nga Parlamenti i Kosovës në fillim të vitit 2005 dhe i cili do ta rregullojë prodhimin, reklamimin, marketingun, si dhe vend-konsumimin e prodhimeve të duhanit. Ligji mbi taksën e zhdrejtë i vendosur mbi prodhimet e duhanit në Kosovë, numër 20023/23, i rregullon taksat e zhdrejta të produkteve të duhanit. Ligji gjithashtu specifikon se autoriteti i përcaktuar, qeveritar Kosovar mund të kërkojë që prodhimet e duhanit të mbajnë vërejtje për dëmtimin e shëndetit në secilën njësi (copë, paketim) dhe që banderola për taksën e zhdrejtë të vihen në secilën njësi të produktit të duhanit si provë e pagesës së taksës së zhdrejtë. Ligji i ri krijon detyrim që të kërkohet leje e posaçme për prodhimin dhe importimin e cigareve. Ligji mbi inspektoratin sanitar (higjienik) të Kosovës, numër 2003/22, i rregullon masat preventive mbi efektet e dëmshme të produkteve të duhanit dhe pirjes së duhanit në vende publike (Neni 9f).

Projekt Ligji për Duhanin ka për të sjellë ndryshime të mëdha në prodhimin, reklamimin dhe marketingun, dhe vendin e konsumimit të prodhimeve të duhanit. Ky ligj përfshinë ndalimin e prodhimit dhe distribuimit të cigareve që përmbajnë më tepër se 10 mg katran në një cigare, më tepër se 1 mg nikotinë në një cigare dhe më shumë se 10 mg monoksid karbon në një cigare. Ligji gjithashtu kërkon vendosjen e shenjave mbi rrezikun për shëndet, si dhe të dhënat mbi përmbajtjen e pakos së cigareve me nikotinë, katran dhe monoksid karboni;

ndalimin e reklamimit dhe promovimit e të gjitha formave të produkteve të duhanit; ndalimin e shitjes së produkteve të duhanit në institucione shëndetësore, shkolla, kolegje dhe universitete, në objekte sportive, rekreative dhe kulturore; ndalimin e shitjes me anë të aparateve vetë-shërbyese, në dyqane vetë-shërbyese, shërbime postale, etj.; ndalimin e pirjes së duhanit në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private, në institucione arsimore dhe në vende publike përveç atyre të përcaktuara për pirjen e duhanit. Ligji gjithashtu kërkon edukim shëndetësor të fëmijëve parashkollor dhe personave të rinj. Qeveria e Kosovës do të themelojë një Këshill Profesional për kontrollin e duhanit.

Mediat

Aktualisht, reklamimi i drejtpërdrejtë i prodhimeve të duhanit është i lejuar në kanalet televizive nacionale dhe kablove, radiot nacionale dhe private, në kinema, në revistat dhe gazetat vendore, tabelat e reklamave (billboards) dhe mure të jashtme. Reklamimi i prodhimeve në emisione të ndryshme televizive dhe filma (reklamim indirekt) nuk është i ndaluar.

Qasja dhe distribuimi/shitja e prodhimeve të duhanit në Kosovë

Nuk ka ndalesa mbi shitjen e prodhimeve të duhanit, mirëpo nuk është e lejuar shitja e cigareve me copë apo shitja e pakove të hapura. Cigaret shiten në Kosovë në dyqane të ndryshme, e këtu përfshihen edhe tregu ushqimor dhe ai i gjelbër. Tregu vendor për prodhime të duhanit është i furnizuar me një numër të madh të llojeve të prodhimeve vendore dhe të huaja. Gati të gjitha llojet e cigareve të huaja janë të pranishme në Kosovë. Disa prej tyre janë nga vendet fqinje (Shqipëria, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi), derisa tjerat janë të prodhuara nga kompanitë e mëdha ndërkombëtare (Philip Morris, Marlboro, etj.). Në vend ekzistojnë dy prodhues vendorë të cigareve (Euro-Gold dhe Tobacco Gjilan).

Nuk ka ndalesa mbi shitjen e prodhimeve të duhanit për të miturit të moshës nën 18 vjeçare.

Kontrabandimi

Gjatë dekadës së fundit, si para ashtu edhe pas luftës, shitja ilegale e cigareve u bë burim profiti për persona individual. Shitja ilegale e cigareve të kontrabanduara në dyqane me pakicë si dhe në rrugë nuk ndëshkohej. Në vitin 2003, qeveria e re filloj ta adresoj çështjen e importeve ilegale. Këtë vit, SHPK-ja dhe Policia e UNMIK-ut filloi ti konfiskoj pakot e cigareve të cilat nuk mbajnë banderola (shenjë e taksës së zhdrejtë).

Zonat ku pirja e duhanit është e ndaluar dhe aplikimi i ndalimit të pirjes së duhanit

Nuk ka ndalesa për pirjen e duhanit në vende të mbyllura pune (brenda objekteve) dhe zyre. Pirja e duhanit është e ndaluar në transportin publik civil si dhe në aeroplanë të avio-kompanive vendore dhe atyre ndërkombëtare të cilët fluturojnë prej dhe deri në Aeroportin e Prishtinës. Pirja e duhanit nuk lejohet në Ministrinë e Shëndetësisë, në Institutin Kombëtar

të Shëndetësisë Publike të Kosovës, në institucionet shëndetësore dhe ndërtesat e qeverisë, por as në teatro dhe kinema përveç në vende të caktuara.

Aktivitetet mbi kontrollin e duhanit

Gjatë disa viteve të fundit ka pasur një numër të fushatave mbi parandalimin dhe ndërprerjen e pirjes së duhanit, të bazuara mbi kampanjat e mëhershme vendore dhe ndërkombëtare dhe të financuara nga ana e organizatave jo-qeveritare ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore. Në mesin e tyre ishte Dita Botërore **Pa-Duhan** (31 maj) dhe fushata kombëtare “Mos pi duhan, ha një mollë.” Këto fushata dhe aksione sjellin dobi të kufizuar. Nuk janë të bazuara në ndonjë strategji për kontrollin e duhanit, por janë të fokusuara në vetë fushatën. Forma dhe përmbajtja e tyre nuk është e bazuar në mësimet e nxjerra nga fushatat e mëparshme. Gjithashtu nuk janë të bazuara në prova të nxjerra nga vlerësimet se sa efektive ato janë në bazë të rezultateve. Andaj, shumë mund të jetë shpenzuar por nuk ka demonstrim se çfarë ndikimi kanë pasur këto aktivitete. Tani për tani nuk ekziston ndonjë Komision Kombëtar për parandalimin e duhanpirjes i cili do të koordinonte të gjitha aktivitetet e drejtuara ndaj parandalimit dhe ndërprerjes së pirjes së duhanit.

Aktivitetet dhe ngjarjet kulturore dhe sportive vazhdojnë të jenë të sponzoruar nga kompanitë e duhanit (Kosova Tobacco, British American Tobacco).

Anketa Globale e të Rinjve mbi Duhanin– Qëllimet dhe Objektivat

Në vitin 1998, OBSH, në partneritet me Qendrat e SHBA-së për Kontrollim dhe Parandalim të Sëmundjeve (US Centers for Disease Control and Prevention) dhe Shoqata Kanadeze për Shëndetësi Publike (Canadian Public Health Association - CPHA), filloi një projekt të quajtur Anketa Globale e të Rinjve mbi Duhanin (GYTS). Synimi i kësaj iniciative ishte ta avancojë mbikëqyrjen e duhanpirjes te të rinjtë. Që nga qershori i vitit 2004, GYTS është zbatuar në mbi 160 vende, prej të cilave 20 gjenden në rajonin Evropian të OBSH-së. Në fillim të vitit 2004, GYTS u zbatua për herë të parë në Kosovë, me ndihmën financiare dhe teknike të CPHA-së.

GYTS ofron një mekanizëm me anë të cilit një vend mund ta monitoroj përdorimin e duhanit te të rinjtë e moshës 13-15 vjeçare dhe të udhëzojë implementimin dhe vlerësimin e programeve për parandalimin dhe kontrollimin e duhanit. Synon që të kuptojë dhe vlerësojë qëndrimet, diturinë dhe sjelljet e ndërlidhura me përdorimin e duhanit dhe ndikim e duhanit në shëndet, duke përfshirë: ndërprerjen, pirjen pasive, mediat dhe reklamimin, qasjen e të miturve dhe programet shkollore. GYTS i përfshin këto çështje:

- Nivelin e përdorimit të duhanit
- Moshën me të cilën fillon përdorimi i duhanit
- Nivelin e predispozitës që të bëhen duhanpirës
- Ekspozim ndaj reklamimit të duhanit

- Variablat kryesore ndërmjetësuese, siç janë qëndrimet dhe besimet se cilat janë normat e sjelljes në lidhje me përdorimin e duhanit në mesin e të rinjve dhe të cilat mund të përdoren në programe parandaluese
- Masën deri në të cilën programet kryesore preventive po arrijnë te popullata shkollore dhe themelojnë mendime subjektive të këtyre popullatave në lidhje me këto intervenime.

GYTS Procedura e marrjes së mostrave në Kosovë

GYTS-i Kosovar i vitit 2004 është anketë e bazuar në shkolla e cila përdorë model me grup mostër dy-fazorë në mënyrë që të krijoj mostër reprezentative të nxënësve të klasës së 6^{te}, 7^{te}, 8^{te} dhe 9^{te} të shkollës fillore dhe viteve 1 deri 4 të shkollës së mesme. Kjo përfshirje e gjerë e klasave u bë objektivi i studimit në kohën kur sistemi arsimor në Kosovë po i nënshtrohej një procesi të reformave, me të cilat objektet arsimore fillestare dhe të mesme po transformoheshin në tri nivele: fillestar, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Grupi i popullatës së zgjedhur për studim, nxënësit e moshës 13 deri 15 vjeçare, ishin të regjistruar në të gjitha klasët e zgjedhura për studim.

Korniza për zgjedhjen e mostrës në fazën e parë përbëhej prej të gjitha shkollave fillore dhe të mesme që përmbanin klasët e zgjedhura. Shkollat u zgjedhën me probabilitet proporcional me numrin e nxënësve të regjistruar në shkollë. Përzgjedhja është bërë në gjithsej 656 shkolla, me 403,239 nxënës të regjistruar (në vitin 2003) dhe 197,985 nxënës në klasët e zgjedhura, që i përshtateshin kriterëve për pjesëmarrje në GYTS. Gjithsej 110 shkolla (55 shkolla fillore dhe 55 shkolla të mesme, që përfaqësonin shkollat në gjuhën shqipe si dhe ato në gjuhën serbe) u zgjedhën të marrin pjesë në GYTS. Faza e dytë e zgjedhjes së mostrave përbëhej prej zgjedhjes së mostrës me probabilitet të barabartë sistematik, që fillonte me metodën e rastit, të klasëve prej secilës shkollë që morën pjesë në studim. Të gjitha klasët në shkollat e zgjedhura të cilat përmbanin 40 apo më shumë nxënës ishin të përfshirë në kornizën e zgjedhjes së mostrës. Të gjithë nxënësit e klasëve të zgjedhura (7,965 nxënës) iu përshtateshin kriterëve për përzgjedhje si pjesëmarrës të studimit.

Faktori i peshës u aplikua në regjistrin e secilit nxënës për t'iu përshtatur rasteve ku mungonte përgjigja dhe për probabilitetet variabile të përzgjedhjes. Për GYTS-in e Kosovës të vitit 2004, u plotësuan 7,088 pyetësor nëpër shkolla (6,419 në shkollat në gjuhën shqipe dhe 669 në shkollat në gjuhën serbe). Përqindja me të cilën të gjitha shkollat në Kosovë u përgjigjen ishte 98.18% (108 prej 110 shkollave të përzgjedhura), kurse përqindja e nxënësve që u përgjigjen ishte 88.99%. Përqindja e përgjithshme për të gjitha shkollat e hulumtuara ishte 87.37%. Prej shkollave në gjuhën shqipe, 98 % e shkollave (98 prej 100 shkollave të përzgjedhura) iu përgjigjen studimit, kurse 89.38% e nxënësve dhanë përgjigje, pra u përgjigjen me përqindje të përgjithshme prej 87.59%. Prej shkollave në gjuhën serbe, 100 % e shkollave (10 prej 10 shkollave të përzgjedhura) u përgjigjen studimit, kurse 85.33% e nxënësve dhanë përgjigje, pra u përgjigjen me përqindje të përgjithshme prej 85.33%.

Matja e peshës

Secilit pyetësor iu është shoqëruar një peshë për ta pasqyruar mundësinë e futjes së secilit nxënës në mostër dhe për ta zvogëluar mundësinë e paragjyqimeve (njëanshmërinë) duke kompensuar për mundësitë e modeleve të ndryshme të mungesës së përgjigjeve. Pesha e përdorur për llogaritje jepet me:

$$W = W1 * W2 * f1 * f2 * f3 * f4$$

W1 = inversioni i probabilitetit për përzgjedhjen e shkollës

W2 = inversioni i probabilitetit për përzgjedhjen e klasës përbrenda shkollës

f1 = faktori i përshtatjes në nivel të shkollës për mos-përgjigje i llogaritur sipas kategorisë së madhësisë së shkollës (e vogël, e mesme, e madhe).

f2 = faktori i përshtatjes i llogaritur sipas shkollës

f3 = faktori i përshtatjes në nivel të nxënësit i llogaritur sipas klasës

f4 = faktori i përshtatjes pas stratifikimit i llogaritur sipas gjinisë dhe klasës

Përdorimi i Rezultateve të Matura

Rezultatet e matura mund të përdoren për të nxjerrë përfundime në lidhje me sjelljet e rrezikshme të përdorimit të duhanit të nxënësve në klasët e gjashta gjer në ato të nënta të shkollave fillore dhe nxënësve në klasët e para gjer në ato të katërta të shkollave të mesme.

Pyetëtori

Pyetëtori përbëhet prej dy pjesëve kryesore: 88 pyetjeve kryesore (të hartuara veçanërisht për rajonin Evropian) dhe prej 4 pyetjeve zgjedhore mbi faktorët e tjerë që e shoqërojnë përdorimin e duhanit. Gjithsej, pyetëtori përmbante 92 pyetje me shumë përgjigje të mundshme për secilën pyetje. Pyetëtori ishte i përkthyer nga gjuha angleze në atë serbe dhe shqipe. Pyetjet kryesore ishin të përqëndruara mbi shtatë tema:

- prevalenca e pirjes së duhanit
- qasja e të miturve tek duhani
- ndërprerja e pirjes së duhanit
- dijenia dhe qëndrimet
- programi shkollor i ndërlidhur me duhanin
- mediat dhe reklamimi, dhe
- duhanpirja pasive.

Grumbullimi i të dhënave

Para grumbullimit të të dhënave, kordinatorët e hulumtimit dhe ekipet e hulumtimit, të vendosura në Prishtinë dhe Mitrovicë, u trajnuan mbi metodat hulumtuese të GYTS-it nga ana e përfaqësuesve të Shoqatës Kanadeze për Shëndetësi Publike të cilët ishin trajnuar nga CDC dhe kishin marrë pjesë në trajnimet paraprake mbi kordinimin e hulumtimit për GYTS. Drejtorëve të shkollave të përzgjedhura iu dërguan kërkesa të shkruara për ta lejuar zbatimin e hulumtimit. Një pako informative u dërgua në të gjitha shkollat që përmbante letrën përkrahëse të dhënë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, një përshkrim të shkurtër mbi qëllimet dhe procedurat e hulumtimit, që e theksonte premtimin mbi ruajtjen e privatitetit, si dhe letrën informative mbi GYTS-in për prindërit.

Procedura e hulumtimit u modelua në atë mënyrë që të mbronte privatitetin e nxënësve duke lejuar pjesëmarrje anonime dhe vullnetare. Pyetëtori i vetë-administruar u administrua mbrenda klasëve të shkollës. Nxënësit i shënonin përgjegjet e tyre drejtpërdrejt në faqen e përgjigjeve me laps special, të cilat pastaj kontrolloheshin me anë të kompjuterit.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (përgjegjës për zbatimin e GYTS-it në shkollat në gjuhën shqipe) dhe Instituti për Shëndetësi Publike në Mitrovicë (përgjegjës për zbatimin e GYTS-it në shkollat në gjuhën serbe) e bënë kordinimin e mbledhjes së të dhënave. Hulumtimi u implementua nga ana e ekipit hulumtues kordinues në këto dy Institute. Ky ekip e zbatoi planifikimin logjistik dhe trajnimin e hulumtuesve për teren. Përkrahje logjistike shtesë u dha nga ana e Zyrës Rajonale për Evropën Jug-lindore të Shoqatës kanadeze për Shëndetësi Publike, e vendosur në Beograd, si dhe nga UNICEF-i në Kosovë. Hulumtimi u zbatua në klasët e zgjedhura nga ana e 20 intervistuesëve të trajnuar nga Kosova (13 për shkollat në gjuhën shqipe dhe 7 për shkollat në gjuhën serbe).

Mbledhja e të dhënave u bë gjatë muajve prill dhe maj 2004. Të gjitha faqet e përgjegjeve dhe faqet kyesore për të dhënat e shkollave dhe klasëve u dërguan në institutet e lartpërmendura për tu validuar. Pas zbatimit të kontrollit të cilësisë të faqeve më përgjegje, që mund të kontrolloheshin me kompjuter, si dhe verifikimit dhe kompletimit të tërë dokumentacionit, materiali i hulumtimit u paketua dhe iu dërgua CDC-së. Kontrollimi i të dhënave dhe kompilimi i skedarëve u bënë në CDC.

Analiza Statistikore

Pakoja programore kopmujterike, EPI Info 2000 është përdorur për përpunimin e modelit kompleks të zgjedhjes së mostrës dhe për matjen e faktorëve në grupin e të dhënave, për t'i llogaritur gabimet standarde dhe prevalencën. Përqindja e prevalencës përshkruhet në këtë raport duke i dhënë llogaritjeve 95% të intervaleve të besueshmërisë (CI – *confidence intervals*). Grupi hulumtues nga Kosova mori pjesë në një trajnim dhe atele pune mbi analizën e të dhënave të GYTS në CDC në Atlantë, në nëntor, 2004.

Rezultatet

Prevalenca

Tabela 1A: Përqindja e nxënësve të cilët e pijnë duhanin, Kosovë 2004

| Kategoria | Që kanë pirë cigare ndonjëherë, edhe nëse vetëm një apo dy tymba | Moshë e fillimit të pirjes <10, Ata që kanë pirë cigare ndonjëherë | Përdorimi i tanishëm | Duhanpirësit e tanishëm të cigarës të cilët pijnë: | |
|-----------------|--|--|----------------------|--|----------------------|
| | | | Cigare - Gjithsej | Cigare të pshtjellura me dorë | Cigare të fabrikuara |
| Gjithsej | 37.0 (±3.0) | 20.9 (±2.9) | 13.0 (±1.7) | 23.4 (±4.3) | 88.3 (±2.4) |
| Gjinia | | | | | |
| Djalë | 43.5 (±3.7) | 25.6 (±3.7) | 14.8 (±2.6) | 25.6 (±6.4) | 87.1 (±4.1) |
| Vajzë | 30.4 (±3.7) | 14.5 (±3.5) | 11.3 (±1.7) | 20.4 (±6.3) | 89.7 (±4.5) |
| Klasa | | | | | |
| Fillore | 37.0 (±7.4) | 29.0 (±9.0) | 12.9 (±6.6) | 11.1 (±13.9) | 94.4 (±4.4) |
| Mesme | 53.9 (±4.0) | 18.2 (±3.7) | 23.5 (±3.9) | 19.1 (±4.1) | 90.5 (±2.6) |

Më shumë se 1/3 (37.0%) e të gjithë nxënësve kanë pirë cigare ndonjëherë. 1/5 (20.9%) e atyre që ndonjëherë kishin pirë cigare kishin filluar para moshës 10 vjeçare (Tabela 1A). Më shumë se 1 prej 10 nxënësve (13.0%) tani e pijnë cigaren. Një numër shumë më i madh i djemve në krahasim me vajzat ndonjëherë kishin pirë cigare (43.5% dhe 30.4% respektivisht) dhe kishin filluar para moshës 10 vjeçare (25.6% e djemve në krahasim me 14.5% e vajzave). Nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm në mes të djemve dhe vajzave sa i përket pirjes së tanishme të duhanit. Mbi 1 prej 5 (23.4%) pirësve të tanishëm përdorin cigare të pshtjellura me dorë dhe gati 9 në 10 (88.3%) përdorin cigare të fabrikuara. Nuk kishte dallim të rëndësishëm statistikor në mes të djemve dhe vajzave.

Sa i përket nxënësve të shkollave fillore, mbi 1/3 (37.0%) ndonjëherë kishte pirë cigare, në krahasim me mbi 1/2 (53.9%) e nxënësve të shkollave të mesme. Gati 1 prej 3 (29.00%) nxënësve të shkollave fillore kishin filluar të pijnë duhan para moshës 10 vjeçare, në krahasim me gati 1 prej 5 (18.2%) nxënësve të shkollave të mesme. Pak më shumë se 1 prej 10 (12.9%) nxënësve të shkollave fillore dhe gati 1/4 (23.5%) e nxënësve të shkollave të mesme janë duhanpirës aktual të duhanit. Mbi 1/10 (11.1%) e nxënësve të shkollave fillore dhe gati 2 prej 10 (19.1%) nxënësve të shkollave të mesme pijnë cigare të pshtjellura me dorë. Shumica (94.4% e nxënësve të shkollave fillore dhe 90.5% e nxënësve të shkollave të mesme) pijnë cigare të fabrikuara.

Tabela 1B: Përqindja e nxënësve të cilët përdorin produkte tjera të duhanit, Kosovë 2004

| Kategoria | Përdorimi i tanishëm | | | | |
|-----------------|--------------------------------------|-------------|----------------------|------------|---|
| | Produkte tjera të duhanit – Gjithsej | Puro | Përtyt, burnot, zhyt | Lullë | Çfardo përdorimi i tanishëm i duhanit– Cigare + Tjera |
| Gjithsej | 10.3 (±1.3) | 6.6 (±1.0) | 6.0 (±1.0) | 4.3 (±0.9) | 17.1 (±1.7) |
| Gjinia | | | | | |
| Djalë | 12.5 (±1.8) | 8.2 (±1.5) | 6.8 (±1.3) | 5.0 (±1.3) | 19.8 (±2.4) |
| Vajzë | 7.9 (±1.4) | 4.9 (±1.1) | 5.2 (±1.2) | 3.5 (±0.9) | 14.3 (±1.8) |
| Klasa | | | | | |
| Fillore | 8.2 (±4.2) | 7.4 (±3.9) | 1.6 (±1.7) | 1.8 (±1.7) | 13.9 (±6.2) |
| Mesme | 13.7 (±2.6) | 10.0 (±2.0) | 7.5 (±1.7) | 5.3 (±1.5) | 26.7 (±3.6) |

Një prej dhjetë (10.3%) duhanpirësve të tanishëm përdorin produkte tjera pos cigareve; 6.6% pijnë puro, 6.6% përtytin, përdorin burnot apo zhytin dhe 4.3% përdorin llullë (Tabela 1B). Gati 1/5 (17.1%) e nxënësve janë pirës të tanishëm të cigareve dhe produkteve tjera të duhanit. Më shumë djem përdorin produkte tjera të duhanit (12.5%) dhe puro (8.2%) se sa vajzat (7.9% përdorin produkte tjera të duhanit dhe 4.9% përdorin puro). Djemtë në numër mjaft më të madh se vajzat përdorin cigare dhe produkte tjera të duhanit..

Gati 1 prej 10 (8.2%) nxënësve të shkollave fillore raportuan të kenë përdorur produktet tjera të duhanit, në krahasim me më shumë se 1/10 (13.7%) e nxënësve të shkollave të mesme. Nxënësit e shkollave të mesme në numër më të madh (7.5%) përtytin, zhytin apo përdorin burnot, në krahasim me nxënësit e shkollave fillore (1.6%). Situata është e ngjajshme në lidhje me përdorimin e llullës (5.3% e nxënësve të shkollave të mesme në krahasim me 1.8% të nxënësve të shkollave fillore. Sa i përket të gjitha produkteve tjera të duhanit (cigare dhe produktet tjera të duhanit) një numër mjaft më i madh i nxënësve të shkollave të mesme (mbi 1/4 – 26.7%) janë përdorues të tanishëm, në krahasim me nxënësit e shkollave fillore (mbi 1 prej 10 – 13.9%).

Tabela 1C: Përqindja e nxënësve që raportuan varësi dhe ndjeshmëri ndaj duhanit, Kosovë 2004

| Kategoria | Përqindja e pirësve të tanishëm të cilët gjithnjë e kanë ndier apo e ndiejnë nevojën për ta pirë cigare menjëherë në mëngjez | Përqindja e nxënësve të cilët nuk e pijnë duhanin por ka mundësi që të fillojnë mbrenda vitit të ardhshëm |
|-----------------|--|---|
| Gjithsej | 17.6 (±6.0) | 11.4 (±1.9) |
| Gjinia | | |
| Djalë | 17.7 (±9.3) | 13.0 (±2.5) |
| Vajzë | 17.0 (±5.7) | 10.1 (±2.3) |
| Klasa | | |
| Filllore | 19.6 (±13.6) | 20.6 (±4.1) |
| Mesme | 17.7 (±7.1) | 12.5 (±1.8) |

Gati 1 prej 5 (17.6%) nxënësve që tani e pijnë duhanin tregojnë prirje të jenë të varur ndaj cigareve (ndiejnë nevojën ta nderin cigarën menjëherë në mëngjez). Megjithatë, nuk kishte dallim të rëndësishëm statistikor në mes të djemve dhe vajzave. Më shumë se 1 prej 10 (11.4%) nxënësve që kurrë nuk e kishin pirë duhanin kanë prirje që të fillojnë dikur mbrenda vitit të ardhshëm. Djemtë të cilët kurrë nuk e kanë përdorur duhanin kanë gjasa më të mëdha se sa vajzat të fillojnë mbrenda vitit të ardhshëm (Tabela 1C).

Nuk kishte dallim të rëndësishëm statistikor në mes të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme sa i përket proporcionit të pirësve të tanishëm të cilët e ndiejnë nevojën për te pirë cigare sa zgjohen në mëngjez, me gati 2 prej 10 nxënës venë të dy rastet (19.6% e nxënësve të shkollave fillore dhe 17.7% e atyre të shkollave të mesme). Një numër mjaft më i madh i nxënësve të shkollave fillore (mbi 1/5 – 20.6%) kanë gjasa më të mëdha të fillojnë ta pijnë duhanin gjatë vitit të ardhshëm, në krahasim me mbi 1 prej 10 (12.5%) nxënësve të shkollave të mesme.

Tabela 2: Programi Shkollor, Kosovë 2004

| Kategoria | Përqindja e cila gjatë vitit të kaluar shkollor kanë mbajtur mësim mbi reziqet e pirjes së duhanit | Përqindja e cila gjatë vitit të kaluar shkollor kanë diskutuar në orë mësimi arsyet pse moshatarët e tyre pijnë duhan | Përqindja e cila gjatë vitit të kaluar shkollor kanë mbajtur mësim mbi ndikimin e pirjes së duhanit |
|-----------------|--|---|---|
| Gjithsej | 58.4 (±3.0) | 51.2 (±2.3) | 53.8 (±2.4) |
| Gjinia | | | |
| Djalë | 55.9 (±3.6) | 49.8 (±2.9) | 51.4 (±2.8) |
| Vajzë | 61.2 (±3.6) | 52.6 (±2.5) | 56.3 (±3.1) |
| Klasa | | | |
| Primary | 54.0 (±9.4) | 48.2 (±5.2) | 48.5 (±6.1) |
| Secondary | 55.9 (±3.7) | 53.2 (±3.1) | 52.6 (±2.5) |

Gati 6 prej 10 (58.4%) nxënësve kishin mësuar në shkollë (gjatë vitit të kaluar shkollor) mbi reziqet e pirjes së duhanit (Tabela 2) dhe mbi gjysma (51.2%) e tyre raportuan se në klasë, gjatë vitit të kaluar shkollor, kishin diskutuar mbi arsyet për të cilat adoleshentët e pijnë duhanin. Gjithashtu, mbi gjysma (53.8%) raportuan se kishin diskutuar në klase mbi efektet e pirjes së duhanit. Nuk kishte dallim të veçantë statistikor në mes të djemëve dhe vajzave.

Një trend i ngjajshëm del nga mesi i nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, ku më shumë se gjysma (54.0% and 55.9% respektivisht) kishin mësuar për reziqet e pirjes së duhanit dhe gati gjysma (48.2% e nxënësve të shkollave fillore dhe 53.2% e nxënësve të shkollave të mesme) raportuan se gjatë vitit të kaluar shkollor kishin marrë pjesë në orë mësimi ku u diskutuan arsyet për të cilat moshatarët e tyre e pijnë duhanin. Në të dy rastet, gati gjysma e nxënësve (48.5% e nxënësve të shkollave fillore dhe 52.6% e nxënësve të shkollave të mesme) kishin marrë pjesë në orë mësimi gjatë vitit të kaluar shkollor ku janë ligjeruar efektet e pirjes së duhanit.

Ndërprerja

Tabela 3: Ndërprerja, Kosovë 2004

| Kategoria | Pirësit e tanishëm të duhanit | | |
|-----------------|------------------------------------|--|--|
| | Perqindja që dëshiron ta ndërprejë | Përcqindja e cila provoi ta ndërprejë këtë vit | Iu dha ndihmë/këshillë që ta ndërprej pirjen e duhanit |
| Gjithsej | 63.0 (±7.3) | 71.0 (±6.9) | 73.3 (±3.4) |
| Gjinia | | | |
| Djalë | 67.9 (±9.3) | 75.1 (±10.6) | 69.6 (±5.0) |
| Vajzë | 56.9 (±10.2) | 65.4 (±8.2) | 77.7 (±5.0) |
| Klasa | | | |
| Fillore | 52.9 (±7.0) | 73.5 (±21.0) | 62.1 (±8.4) |
| Mesme | 59.8 (±8.7) | 69.0 (±8.5) | 75.5 (±3.7) |

Gati 2/3 (63.0%) e pirësve të tanishëm të duhanit treguan dëshirë ta ndërprejnë, derisa gati 3/4 (71.0%) e tyre kishte provuar ta ndërprej dikur gjatë vitit të kaluar (Tabela 3). Gati 3/4 (73.3%) e pirësve të tanishëm të duhanit iu kishte dhënë ndihma apo këshilla që ta ndërprejnë. Nuk kishte dallim të veçantë statistikor në mes të djemve dhe vajzave.

Mbi gjysma (52.9%) e nxënësve të shkollave fillore dhe gati 6 prej 10 (59.8%) nxënësve të shkollave të mesme dëshironin ta ndërprenin pirjen e duhanit. Gati 3/4 (73.5%) e nxënësve të shkollave fillore dhe mbi 2/3 (69.0%) e nxënësve të shkollave të mesme kishin provuar ta ndërprejnë dikur gjatë vitit të kaluar. Më pak se 2/3 (62.1%) e nxënësve të shkollave fillore, në krahasim me 3/4 (75.5%) e nxënësve të shkollave të mesme, kishin marrë ndihmë apo këshillë në lidhje me ndërprejen e pirjes së duhanit.

Duhanpirja pasive në mjedis

Tabela 4A: Duhanpirja pasive në mjedis, Kosovë 2004

| Kategoria | Që iu kanë ekspozuar tymbit të duhanit në shtëpi | | Që iu kanë ekspozuar tymbit të duhanit të babave të tyre | | Që iu kanë ekspozuar tymbit të duhanit të nënave të tyre | |
|-----------------|--|-------------------|--|-------------------|--|-------------------|
| | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës tanishëm të | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës tanishëm të | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës tanishëm të |
| Gjithsej | 82.0 (±1.8) | 95.0 (±1.9) | 55.7 (±2.9) | 67.8 (±4.9) | 27.0 (±2.8) | 45.2 (±6.5) |
| Gjinia | | | | | | |
| Djalë | 80.0 (±3.0) | 94.2 (±2.8) | 55.2 (±4.6) | 65.4 (±6.6) | 25.5 (±3.6) | 41.9 (±7.6) |
| Vajze | 83.8 (±1.8) | 96.0 (±2.4) | 56.2 (±3.3) | 71.6 (±6.0) | 28.3 (±3.8) | 49.7 (±8.5) |
| Klasa | | | | | | |
| Fillore | 94.9 (±2.9) | 98.7 (±2.7) | 62.2 (±2.7) | 69.7 (±18.8) | 48.1 (±4.2) | 70.2 (±12.0) |
| Mesme | 86.8 (±2.6) | 96.7 (±1.8) | 56.9 (±4.6) | 67.6 (±5.9) | 25.8 (±4.2) | 44.6 (±8.3) |

| Kategoria | Që iu kanë ekspozuar tymbit të duhanit në shtëpi | | Që iu kanë ekspozuar tymbit të duhanit të shokëve të tyre në shtëpi | | Exposed to smoke from others in their home | |
|-----------------|--|-------------------|---|-------------------|--|-------------------|
| | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës tanishëm të | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës tanishëm të | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës tanishëm të |
| Gjithsej | 16.6 (±2.5) | 48.0 (±4.8) | 16.8 (±2.4) | 57.9 (±5.8) | 74.4 (±2.3) | 89.0 (±2.7) |
| Gjinia | | | | | | |
| Djalë | 16.8 (±3.3) | 41.7 (±5.2) | 18.8 (±4.0) | 54.2 (±8.4) | 72.4 (±3.1) | 86.9 (±4.1) |
| Vajzë | 16.5 (±2.8) | 55.1 (±7.0) | 15.3 (±2.4) | 62.9 (±8.0) | 76.1 (±2.8) | 91.4 (±4.2) |
| Klasa | | | | | | |
| Fillore | 15.1 (±4.2) | 51.8 (±11.2) | 25.1 (±6.9) | 80.5 (±10.8) | 92.0 (±2.8) | 95.8 (±4.6) |
| Mesme | 22.4 (±4.7) | 50.5 (±5.4) | 24.4 (±5.4) | 59.7 (±6.9) | 81.2 (±3.7) | 91.7 (±2.7) |

Një numër mjaftë më i madh i duhanpirësve të tanishëm (95.0%) i ekspozohen tymbit të duhanit në shtëpi se sa ata që kurrë nuk e kanë pirë duhanin (82.0%) (Tabela 4A). Si pirësit e tanishëm të duhanit, ashtu edhe ata që kurrë nuk e kanë pirë, më tepër mund ti ekspozohen tymbit të duhanit të etërve të tyre se sa nënave (67.8% dhe 55.7% nga etërit dhe 45.2% dhe 27.0% nga nënat, respektivisht).

Duhanpirësit e tanishëm janë në masë të konsiderushme të ekspozuar ndaj duhanpirësve mjedisor, vëllezërit dhe motrat (48.0%) dhe shokët/shoqet (57.9%), në krahasim me ata që kurrë nuk e kanë pirë duhanin (16.6% dhe 16.8% respektivisht). Gati 9/10 (89.0%) e atyre që kurrë nuk e kanë pirë duhanin dhe gati 3/4 (74.4%) e duhanpirësve të tanishëm i ekspozohen tymbit të personave të tjerë në shtëpitë e tyre. Nuk ka dallim të veçantë statistikor në mes të djemve dhe vajzave në cilën do prej këtyre kategorive.

Sa i përket ekspozimit ndaj tymbit të duhanit në shtëpi, një numër më i madh i nxënësve të shkollave fillore (94.9%), që kurrë nuk kishin pirë duhan, janë të ekspozuar se sa ata të shkollave të mesme që kurrë nuk kishin pirë duhan (86.6%). Nuk ka dallim të veçantë statistikor sa i përket ekspozimit të nxënësve të shkollave fillore të cilët janë pirës të tanishëm të duhanit dhe atyre që kurrë nuk kanë pirë duhan. Mirëpo, ka dallim të theksuar sa i përket ekspozimit të nxënësve të shkollave të mesme, ku një numër më i madh i duhanpirësve të tanishëm (96.7%) janë të ekspozuar se sa ata të cilët kurrë nuk kanë pirë duhan (86.8%). Nuk ka dallim të veçantë statistikor në mes të nxënësve të shkollave fillore

dhe atyre të mesme sa i përket eksponimit në shtëpi si pasojë e asaj se babai është duhanpirës, qofshin ata pirës të tanishëm apo aso që kurrë nuk kanë pirë duhan.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë për një dallim mjaft të madh në mes të atyre që kurrë nuk e kanë pirë duhanin dhe pirësve të tanishëm në shkollat fillore dhe të mesme, si dhe në mes nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të cilët janë pirës të tanishëm dhe atyre që kurrë nuk kanë pirë duhan sa i përket eksponimit si pasojë e asaj se nënat e tyre e pijnë duhanin.

Gati 3/4 (70.2%) e pirësve të tanishëm në shkollat fillore i eksponohen tymit të duhanit për arsye se nënat e tyre e pijnë duhanin, në krahasim me më pak se 1/2 (48.1%) të nxënësve të shkollave fillore të cilët kurrë nuk e kanë pirë duhanin. Këto janë përqindje shumë më të larta se sa ato për shkollat e mesme ku më pak se 1/2 (44.6%) e pirësve të tanishëm dhe pak më shumë se 1/4 (25.8%) e atyre që kurrë nuk e kanë pirë duhanin i eksponohen tymit për arsye se nënat e tyre janë duhanpirëse.

Sa i përket eksponimit të tymit të duhanit nga vëllezërit dhe motrat duhanpirëse, ka dallim të madh në mes të pirësve të tanishëm dhe atyre të cilët kurrë nuk e kanë pirë duhanin, si te nxënësit e shkollave fillore ashtu edhe te ata të shkollave të mesme. Gati gjysma e pirësve të tanishëm (51.8% të shkollave fillore dhe 50.5% të shkollave të mesme) i eksponohen tymit të duhanit si rezultat e asaj se vëllezërit apo motrat e tyre e pijnë duhanin, në krahasim me gati 1/5 e nxënësve që kurrë nuk kishin pirë duhan (15.1% në shkolla fillore dhe 22.4% në shkolla të mesme, pa dallim të madh statistikor në mes të tyre). Gati 1/4 e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme (25.1% dhe 24.4% respektivisht), të cilët kurrë nuk kanë pirë duhan, raportuan se i eksponohen tymit të duhanit si pasojë e asaj se shoku/shoqja më e afërt ka pirë duhan në shtëpi. Dallimi është mjaft i madh në mes të shkollave të mesme dhe fillore kur janë në pyetje pirësit e tanishëm të duhanit. Më shumë se gjysma (59.7%) e pirësve të tanishëm në shkolla të mesme dhe më shumë se 3/4 (80.5%) e pirësve të tanishëm në shkolla fillore, raportuan se i eksponohen tymit të duhanit si pasojë e asaj se shoku/shoqja e tyre e pinë duhanin në shtëpi.

Një numër mjaft më i madh i nxënësve të shkollave fillore, të cilët kurrë nuk e kanë pirë duhanin (92.0%), i eksponohen duhanit si rezultat i asaj se njerëzit tjerë e pijnë duhanin në shtëpitë e tyre, se sa ata të shkollave të mesme (81.2%). Derisa nuk ka dallim të madh statistikor në mes të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, të cilët janë pirës të tanishëm të duhanit, sa i përket eksponimit ndaj tymit për arsye se njerëzit e tjerë e pijnë duhanin në shtëpitë e tyre (95.8% dhe 91.7%), këto janë përqindje shumë më të mëdha në krahasim me ato për nxënësit e shkollave fillore të cilët kurrë nuk e kanë pirë duhanin.

Tabela 4B: Duhanpirja pasive në mjedis, Kosovë 2004

| Kategoria | Që i ekspozohen tymit të duhanit të të tjerëve në vende publike | | Perqindja e cila medon se pirja e duhanit duhet të ndalohet në vende publike | | Vendosmërisht mendojnë se është i dëmshëm për ta tymi i duhanit i të tjerëve | |
|-----------------|---|------------------------------|--|------------------------------|--|------------------------------|
| | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës të tanishëm të duhanit | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës të tanishëm të duhanit | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës të tanishëm të duhanit |
| Gjithsej | 72.3 (±2.2) | 88.8 (±2.6) | 94.2 (±1.2) | 80.1 (±2.7) | 72.0 (±3.4) | 54.2 (±4.6) |
| Gjinia | | | | | | |
| Djalë | 73.7 (±2.3) | 87.7 (±4.2) | 92.8 (±1.8) | 82.4 (±4.0) | 70.2 (±3.4) | 54.7 (±5.9) |
| Vajzë | 71.5 (±3.3) | 90.2 (±2.5) | 95.3 (±1.1) | 76.8 (±4.6) | 73.6 (±4.2) | 53.1 (±7.3) |
| Klasa | | | | | | |
| Filllore | 89.8 (±2.5) | 96.5 (±7.6) | 90.1 (±5.6) | 39.1 (±12.8) | 52.5 (±8.7) | 32.2 (±5.3) |
| Mesme | 81.5 (±2.1) | 91.5 (±2.4) | 93.8 (±2.0) | 78.5 (±3.0) | 70.7 (±3.7) | 51.9 (±5.0) |

Gati 9 prej 10 (88.8%) të duhanpirësve aktual dhe 7 prej 10 (72.3%) nxënësve të cilët kurrë nuk kanë pirë duhan i ekspozohen tymit të duhanit të të tjerëve në vende publike (Tabela 4B), që paraqet një dallim të madh statistikor. Gati të gjithë nxënësit të cilët kurrë nuk kishin pirë duhan (94.2%) mendojnë se duhanpirja në vende publike nuk duhet të lejohet, derisa pak më shumë se 3/4 (80.1%) e pirësve të tanishëm të duhanit mendojnë se pirja e duhanit duhet të ndalohet në vende publike (këtu paraqitet një dallim i madh në mes të këtyre dy kategorive). Mbi gjysma (54.2%) e duhanpirësve aktual dhe një numër më i madhe i atyre që kurrë nuk e kishin pirë duhanin (72.0%) mendojnë se tymi ambiental i duhanit është i rrezikshëm për ta. Nuk ka dallim të madh statistikor në mes të djemëve dhe vajzave.

Gati të gjithë nxënësit e shkollave filllore dhe të mesme, të cilët janë pirës të tanishëm dhe të cilët kurrë nuk e kanë pirë duhanin, raportuan se iu kishin ekspozuar tymit të duhanit të njerëzve të tjerë në vende publike (nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor, si në mes të nxënësve të shkollave të mesme dhe atyre filllore, ashtu edhe në mes të atyre që janë pirës të tanishëm dhe atyre që kurrë nuk e kishin pirë duhanin). Megjithatë, derisa gati të gjithë ata të cilët kurrë nuk e kishi pirë duhanin, si për ata të shkollave filllore ashtu edhe të mesme (90.1% dhe 93.8% respektivisht, pa dallim të rëndësishëm statistikor) mendojnë se pirja e duhanit në vende publike duhet të ndalohet. Pak mbi 3/4 (78.5%) e nxënësve të shkollave të mesme, të cilët janë pirës të tanishëm të duhanit, dhe më pak se 4 prej 10 (39.1%) pirësve të tanishëm të duhanit, të cilët janë në shkolla filllore, e kanë të njejtin mendim. Gati 3/4 (70.7%) e nxënësve të shkollave të mesme, të cilët kurrë nuk e kishin pirë duhanin, vendosmërisht mendojnë se është i dëmshëm për ta tymi i duhanit i të tjerëve, në krahasim me pak më shumë se gjysmën (52.2%) e nxënësve të shkollave filllore të cilët kurrë nuk kishin pirë duhan dhe 51.9% e duhanpirësve aktual në shkollat e mesme. Më pak se 1/3

(32.2%) e nxënësve të shkollave fillore, të cilët janë duhanpirës aktual mendojnë se është i dëmshëm për ta tymi i duhanit i të tjerëve.

Dijenja dhe Qëndrimet

Tabela 5: Diçjenja dhe Qëndrimet, Kosovë 2004

| Kategoria | Mendojnë se djemtë të cilët e pijnë duhanin kanë më tepër shokë/shoqe | | Mendojnë se vajzat të cilat e pijnë duhanin kanë më tepër shokë/shoqe | | Mendojnë se pirja e duhanit i bënë djemtë të dukën më tërheqës | | Mendojnë se pirja e duhanit i bënë vajzat të dukën më tërheqëse | |
|-----------------|---|------------------------------|---|------------------------------|--|------------------------------|---|------------------------------|
| | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës të tanishëm të duhanit | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës të tanishëm të duhanit | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës të tanishëm të duhanit | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës të tanishëm të duhanit |
| Gjithsej | 14.1 (±2.4) | 30.4 (±5.3) | 13.9 (±2.1) | 27.8 (±5.0) | 17.1 (±2.9) | 28.4 (±3.4) | 16.7 (±2.6) | 24.7 (±3.6) |
| Gjinia | | | | | | | | |
| Djalë | 15.6 (±2.9) | 28.4 (±5.8) | 15.9 (±2.9) | 25.8 (±6.7) | 20.1 (±4.1) | 29.6 (±4.9) | 20.5 (±4.1) | 26.6 (±4.7) |
| Vajzë | 13.0 (±2.6) | 33.3 (±7.8) | 12.4 (±2.4) | 30.6 (±6.4) | 14.7 (±3.1) | 27.1 (±5.3) | 13.6 (±2.8) | 22.5 (±4.8) |
| Klasa | | | | | | | | |
| Filllore | 11.2 (±4.0) | 11.1 (±12.2) | 12.2 (±4.5) | 12.1 (±11.0) | 11.7 (±3.4) | 13.3 (±8.6) | 8.1 (±3.1) | 9.6 (±8.4) |
| Mesme | 21.1 (±4.7) | 32.6 (±6.1) | 22.5 (±4.1) | 30.5 (±5.6) | 18.4 (±4.6) | 27.2 (±3.8) | 18.0 (±4.0) | 23.1 (±3.8) |

Më shumë se 1/10 (14.1%) e nxënësve të cilët kurrë nuk kishin pirë duhan mendojnë se djemtë të cilët e pijnë duhanin kanë më shumë shokë/shoqe, në krahasim me më pak se 1/3 (30.4%) e pirësve të tanishëm të duhanit (Tabela 5). Përafërsisht numri i njejtë i nxënësve të cilët tani e pijnë duhanin (27.8%) dhe të cilët kurrë nuk e kishin pirë duhanin (13.9%) mendojnë se vajzat të cilat e pijnë duhanin kanë më tepër shokë/shoqe. Ka dallim të rëndësishëm statistikor në mes të atyre që janë pirës të tanishëm të duhanit dhe atyre që kurrë nuk e kishin pirë duhanin në lidhje me mendimin se djemtë dhe vajzat që e pijnë duhanin janë më tërheqës. Gati 1 prej 3 (28.4%) pirësve të tanishëm të duhanit mendojnë se pirja e duhanit i bënë djemtë më tërheqës, në krahasim me më pak se 1/5 (17.1%) e atyre që kurrë nuk e kishin pirë duhanin. Gati 1/4 (24.7%) e pirësve të tanishëm mendojnë se pirja e duhanit i bënë vajzat më tërheqëse, në krahasim me 1/5 (16.7%) e atyre që kurrë nuk e kishin pirë duhanin. Nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor në mes të djemve dhe vajzave.

Sa i përket dallimeve në mes të nxënësve të shkollave fillore dhe shkollave të mesme, shumë më tepër nxënës të shkollave të mesme, të cilët janë duhanpirës aktual, mendojnë se djemtë të cilët e pijnë duhanin kanë më tepër shokë/shoqe, se sa nxënësit e shkollave fillore, të cilët janë pirës të tanishëm të duhanit (32.6% dhe 11.1% respektivisht). Një e dhënë mjaft interesante është mungesa e dallimeve në mes të nxënësve të shkollave fillore të cilët kurrë nuk kishin pirë duhan dhe pirësve të tanishëm sa i përket mendimit se djemtë të cilët e pijnë duhanin kanë më tepër shokë/shoqe. Gjithashtu, sa i përket kësaj çështjeje nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor në mes të nxënësve të shkollave të mesme, të cilët janë duhanpirës aktual dhe atyre që nuk e kishin pirë duhanin. Të dhënat e njejtë i gjejmë edhe sa i përket

mendimit se vajzat të cilat pijnë duhan kanë më tepër shokë/shoqe dhe mendimi se pirja e duhanit i bënë djemtë dhe vajzat të duken më tërheqës. Mirëpo, një pjesë mjaft më e madhe e nxënësve të shkollave të mesme, të cilët janë duhanpirës aktual, mendojnë se pirja e duhanit i bënë djemtë dhe vajzat të duken më tërheqës.

Mediat dhe Reklamimi

Tabela 6A: Mediat dhe Reklamimi, Kosovë 2004

| Kategori | Përqindja e cila kishte parë porosi mediale kundër pirjes së duhanit në televizor | Përqindja e cila kishte dëgjuar porosi mediale kundër pirjes së duhanit në radio | Përqindja e cila kishte parë porosi mediale kundër pirjes së duhanit në tabela lajmërimesh | Përqindja e cila kishte parë porosi mediale kundër pirjes së duhanit në pllakate | Përqindja e cila kishte parë porosi mediale kundër pirjes së duhanit në gazeta dhe revista | Përqindja e cila kishte parë porosi mediale kundër pirjes së duhanit në kinema | Përqindja e cila kishte parë porosi mediale kundër pirjes së duhanit gjatë ndodhive sportive, në panairë, koncerte apo ndodhi të bashkësive |
|-----------------|---|--|--|--|--|--|---|
| Gjithsej | 82.9 (±1.4) | 74.4 (±1.9) | 59.4 (±2.2) | 58.9 (±2.2) | 65.0 (±2.0) | 71.4 (±2.2) | 67.7 (±2.2) |
| Gjinia | | | | | | | |
| Djal | 82.7 (±2.2) | 74.0 (±3.1) | 60.9 (±2.5) | 60.1 (±2.7) | 65.1 (±2.9) | 71.4 (±2.7) | 68.7 (±2.8) |
| Vajzë | 83.2 (±1.4) | 75.0 (±2.1) | 57.9 (±2.7) | 57.9 (±2.7) | 65.1 (±2.3) | 71.4 (±3.0) | 66.9 (±2.4) |
| Klasa | | | | | | | |
| Filllore | 83.4 (±3.7) | 51.8 (±6.3) | 37.5 (±3.3) | 56.6 (±5.6) | 64.4 (±1.9) | 65.0 (±7.3) | 70.7 (±3.1) |
| Mesme | 82.1 (±2.8) | 70.8 (±3.1) | 58.2 (±3.4) | 58.9 (±4.2) | 61.9 (±3.1) | 67.9 (±4.2) | 69.9 (±2.7) |

Mbi 8 prej 10 (82.9%) nxënësve kishte parë porosi kundër pirjes së duhanit në televizion dhe gati 3/4 (74.4%) e nxënësve kishte dëgjuar porosi kundër pirjes së duhanit në radio (Tabela 6A). Një numër përafërsisht i njejtë i nxënësve (gati 6 prej 10) kishte parë porosi kundër pirjes së duhanit në tabela lajmërimesh (59.4%) dhe në pllakate (58.9%). Gati 2/3 (65.0%) e nxënësve kishte parë porosi të tilla në gazeta, revista dhe në kinema (67.7%), derisa gati 3/4 (71.4%) e tyre i kishte parë në kinema. Nuk ka patur dallime të rëndësishme sa i përket gjinisë. Gjithashtu, nuk ka patur dallim të rëndësishëm sa i përket numrit të nxënësve të shkollave fillore dhe shkollave të mesme të cilët raportuan se kishin parë porosi kundër pirjes së duhanit në televizor apo pllakat, në gazeta/revista, apo në kinema, ndodhi sportive apo ndodhi tjera të bashkësive. Një numër mjaft më i madh i nxënësve të shkollave të mesme, në krahasim me ata të shkollave fillore, raportuan se kishin dëgjuar porosi mediale kundër pirjes së duhanit në radio apo që i kishin parë ato në tabela lajmërimesh.

Tabela 6B: Mediat dhe Reklamimi, Kosovë 2004

| Kategori | Përqindja që kishte parë në televizor porosi pro-duhan | Përqindja që kishte parë porosi në tabela lajmërimesh pro-duhan | Përqindja që kishte parë në gazeta/revista porosi pro duhan | Përqindja që kishte parë reklama pro-duhan për cigarë gjatë ndodhive sportive | Përqindja që kishte parë reklama pro-duhan për cigarë në koncerte | Përqindja që kishte parë reklama pro-duhan për cigarë gjatë ndodhive shoqërore |
|-----------------|--|---|---|---|---|--|
| Gjithsej | 79.2 (±2.0) | 72.0 (±2.0) | 74.5 (±1.8) | 71.6 (±2.2) | 63.1 (±2.1) | 60.3 (±2.1) |
| Gjinia | | | | | | |
| Djalë | 79.4 (±2.8) | 72.8 (±2.2) | 74.1 (±2.9) | 70.8 (±2.8) | 63.1 (±3.0) | 60.6 (±2.7) |
| Vajzë | 79.0 (±2.2) | 71.2 (±2.7) | 75.0 (±2.4) | 72.5 (±3.0) | 63.2 (±3.1) | 60.0 (±2.8) |
| Klasa | | | | | | |
| Filllore | 82.7 (±3.1) | 43.7 (±6.3) | 71.8 (±3.2) | 67.5 (±3.4) | 55.3 (±6.0) | 52.7 (±5.3) |
| Mesme | 84.1 (±2.5) | 76.6 (±2.5) | 79.3 (±2.5) | 72.0 (±2.9) | 63.9 (±2.3) | 64.0 (±2.5) |

Gati 8 prej 10 (79.2%) nxënësve kishin parë porosi pro-duhanit në televizion (Tabela 6B). Një numër përafërsisht i njëjtë kishte parë porosi pro-duhanit në tabela lajmërimesh (72.0%), në gazeta dhe revista (74.5%) dhe në evenimente sportive (71.6%). Gati 2/3 (63.1%) e nxënësve kishin dëgjuar porosi pro-duhanit në koncerte dhe evenimente shoqërore (60.3%). Nuk kishte dallim të rëndësishëm sa i përket gjinisë. Një numër mjaft më i madh nxënësve të shkollave të mesme, se sa ata të shkollave filllore, kishin parë porosi pro-duhanit në tabela lajmërimesh, në gazeta/revista dhe në evenimente shoqërore.

Një numër mjaft më i madh (30.3%) i duhanpirësve aktual të duhanit posedojnë ndonjë gjë që mbanë markën e ndonjë lloji të cigareve se sa ata të cilët kurrë nuk e kishin pirë duhanin (16.6%) (Tabela 6C). Një relacion i ngjashëm paraqitet edhe me krahasimin e nxënësve që janë duhanpirës aktual dhe atyre që kurrë nuk kishin pirë duhanin për rastet kur kompanitë e duhanit iu kishin ofruar cigare falas (26.2% e pirësve të tanishëm në krahasim me 12.3% e atyre që kurrë nuk e kishin pirë duhanin). Në mesin e atyre që kurrë nuk kishin pirë duhan, një numër shumë më i madh i djemve se sa i vajzave posedonin ndonjë gjë që mbante markën e ndonjë lloji të cigareve apo iu kishte ofruar cigarja falas nga ana e ndonjë kompanie të duhanit. Nuk kishte dallim të madh në mes të nxënësve të shkollave filllore dhe të mesme, që janë duhanpirës aktual dhe që kurrë nuk e kishin pirë duhanin.

Tabela 6C: Mediat dhe Reklamimi, Kosovë 2004

| Kategoria | Përqindja që posedonte ndonjë gjë që mbante markën e ndonjë lloji të cigareve | | Përqindja cilës ndonjë kompani e duhanit iu kishte ofruar cigare falas | |
|-----------------|---|------------------------------|--|------------------------------|
| | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës të tanishëm të duhanit | Që kurrë nuk kanë pirë duhan | Pirës të tanishëm të duhanit |
| Gjithsej | 16.6 (±1.9) | 30.2 (±4.3) | 12.3 (±1.6) | 26.2 (±5.3) |
| Gjinia | | | | |
| Djalë | 20.4 (±3.2) | 32.4 (±5.4) | 16.2 (±2.6) | 30.7 (±8.6) |
| Vajzë | 13.4 (±1.7) | 27.7 (±6.0) | 9.3 (±1.6) | 20.4 (±4.4) |
| Klasa | | | | |
| Filllore | 25.6 (±6.3) | 25.7 (±5.9) | 20.4 (±3.5) | 15.5 (±8.1) |
| Mesme | 16.6 (±4.0) | 30.1 (±4.8) | 18.3 (±3.6) | 26.3 (±6.5) |

Qasja dhe Dispozicioni

Tabela 7: Qasja dhe Dispozicioni, Kosovë 2004

| Kategoria | Përqindja e pirësve të tanishëm të duhanit të cilët zakonisht e pijnë duhanin në shtëpi | Përqindja e pirësve të tanishëm të duhanit të cilët i blejnë cigaret në dyqan | Përqindja e pirësve të tanishëm të duhanit të cilët kishin blerë cigare në dyqan dhe nuk u refuzuan për shkak të moshës së tyre |
|-----------------|---|---|---|
| Gjithsej | 27.7 (±5.6) | 57.9 (±7.3) | 82.8 (±5.0) |
| Gjinia | | | |
| Djalë | 20.6 (±6.9) | 58.0 (±10.1) | 84.1 (±5.1) |
| Vajzë | 36.5 (±6.2) | 57.3 (±7.1) | 80.7 (±8.8) |
| Klasa | | | |
| Filllore | 30.2 (±11.2) | 75.6 (±15.7) | 98.7 (±2.7) |
| Mesme | 27.0 (±5.4) | 62.6 (±8.0) | 83.3 (±5.3) |

Mbi 1/4 (27.7%) e duhanpirësve aktual zakonisht e pijnë duhanin në shtëpi (Tabela 7). Mbi gjysma (57.9%) e tyre vetë kishte blerë cigare në dyqan, gjersa më shumë se 8 prej 10 (82.8%) raportuan se kur kanë blerë cigarë në dyqan ata nuk ishin refuzuar për shkak të moshës së tyre. Nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor sipas gjinisë, përveç të duhanpirësit aktual ku më shumë vajza se sa djem zakonisht e pijnë duhanin në shtëpi. Gjithashtu, nuk ka dallim të madh statistikor në mes të nxënësve të shkollave filllore dhe shkollave të mesme, përveç të numrit të duhanpirësve aktual të cilët kishin blerë cigare në dyqan dhe nuk ishin refuzuar për shkak të moshës së tyre (numri është mjaft më i madh për nxënësit e shkollave filllore).

Diskutimi

Prevalenca

Në Kosovë, më shumë se 1/3 e nxënësve të moshës 13 deri 15 vjeqare kanë pirë cigare. Gati 1/5 e të gjithë nxënësve tani përdorin ndonjë formë të duhanit dhe 13% e tyre janë duhanpirës aktual. Pak më shumë se 1/5 e nxënësve, të cilët ndonjë here kishin pirë duhan, kanë filluar në moshë shumë të re. Cigarja e fabrikuar është prodhimi më i preferuar i duhanit, edhe pse 1/5 e duhanpirësve aktual përdorin cigare të pshtjellura më dorë. Një numër shumë i vogël i duhanpirësve aktual përdorin produkte tjera të duhanit. Nuk ka dallim të madh statistikor sipas gjinisë sa i përket duhanpirësve aktual të cigareve (qofshin ato cigare të fabrikuara apo të pshtjellua me dorë) dhe prodhimeve tjera. Gati 1/5 e duhanpirësve aktual raportuan se kanë dëshirë ta pijnë një cigare posa të zgjohen në mëngjez. Më shumë se 1 prej 10 nxënësve, të cilët kurrë nuk kanë pirë cigare, janë pirës potencial të duhanit.

Megjithatë, të dhënat tregojnë për një dallim të madh mbi prevalencën dhe sjelljet në mes të nxënësve të shkollave fillore dhe shkollave të mesme. Megjithë numrin më të vogël të nxënësve të shkollave fillore të cilët ndonjëherë kishin pirë duhan dhe prevalencën dy herë më të madhe të pirjes së duhanit në shkollat e mesme, një numër mjaft më i madh i nxënësve të shkollave fillore kishin filluar ta pijnë duhanin para moshës 10 vjeqare për dallim nga nxënësit e shkollave të mesme.

Të dhënat gjithashtu tregojnë se prirja e nxënësve të shkollave fillore, të cilët tani nuk e pijnë duhanin, është dy herë më e lartë për të filluar pirjen e duhanit mbrenda 12 muajve të ardhshëm, në krahasim me nxënësit e shkollave të mesme të cilët kurrë nuk e kishin pirë duhanin. Kjo është një qështje për të cilën duhet të brengosemi. Jo vetëm se prevalenca e pirjes së duhanit është mjaftë e lartë te kjo popullatë, por edhe një numër mjaft i madh i tyre fillojnë ta pijnë duhanin në një moshë shumë të re. Të dhënat tregojnë se një numër më i madh i nxënësve të moshës së re gjithashtu e fillojnë pirjen e duhanin në një moshë shumë të re. Në të njëjtën kohë, një numër mjaft i madh i nxënësve të cilët kurrë nuk e kishin pirë duhanin janë në mesin e atyre që kanë gjasa të mëdha të fillojnë ta pijnë duhanin mbrenda 12 muajve të ardhshëm. Kjo do të ketë ndikim të madh shëndetësor pasi që pirja e duhanit në moshë të re e rritë rrezikun e patologjive dhe mortalitetit prej shkaqeve që kanë të bëjnë me duhanin dhe e zvogëlon jetëgjatësinë. Të dhënat gjithashtu tregojnë se pirësit e rinjë kanë më tepër prirje që të bëhen të varur nga duhani. Duke marrë parasysh se një numër më i madh i djemve se sa i vajzave e kanë këtë prirje, mund të konkludohet se djemtë janë në rrezik më të madh se sa vajzat të fillojnë ta pijnë duhanin në vitet e hershme të adoleshencës.

Ndërprerja

Të dhënat tregojnë se më shumë se 2/3 e pirësve të tanishëm të duhanit dëshirojnë ta ndërprejnë pirjen e duhanit dhe gati 3/4 e tyre kishin provuar ta ndërprejnë gjatë vitit të kaluar. Gjithashtu, gati 3/4 së tyre iu kishte ofruar ndihma apo këshilla për ndërprerjen e duhanit. Megjithatë, të dhënat tregojnë se varësia ndaj duhanit është e fortë dhe mund të kundërveproj ndaj kapacitetit të pirësve të moshave të reja për ta ndërprerë pirjen e duhanit.

Nuk ka informata mbi numrin e atyre të cilët me sukses e kishin ndërprerë pirjen e duhanit apo mbi ndikimin e ndihmës apo këshillës që kishin marrë. Nuk kishte dallim të madh në mes të djemve dhe vajzave apo në mes të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme sa i përket numrit të atyre që donin ta ndërprejnë apo që kishin provuar ta ndërprejnë duhanin dikur gjatë vitit të kaluar. Megjithatë, të dhënat tregojnë se një numër më i madh i pirësve të tanishëm që janë nxënës të shkollave fillore nuk kanë kërkuar apo nuk kanë qasje në ndihmë apo këshilla se si ta ndërprejnë pirjen e duhanit. Andaj, pirësve të duhanit të moshave më të reja iu duhet të presin më gjatë që të kenë qasje apo të vendosin të kërkojnë këshilla dhe ndihmë për ta ndërprerë pirjen, gjë që i bën ata të janë në rrezik më të madh për tu bërë të varur në moshë mjaft të re dhe të vazhdojnë ta pijnë duhanin.

Plan-programi shkollor

Edhe pse më shumë se gjysma e nxënësve kishin mësuar apo diskutuar mbi përdorimin e duhanit, si dhe mbi ndikimin e pirjes së duhanit në shëndet, në klasë gjatë vitit të kaluar (pa dallim të madh sipas gjinisë apo nivelit shkollor), një numër mjaft më i vogël i nxënësve të cilët janë pirës të tanishëm të duhanit, në krahasim me ata që kurrë nuk e kishin pirë duhanin, e kuptojnë se tymi i duhanit i të tjerëve është i dëmshëm për ta. Numri i nxënësve të shkollave fillore, të cilët i kuptojnë efektet e dëmshme të tymit të duhanit që vie prej të tjerëve, është mjaft më i vogël se i atyre të shkollave të mesme; gjithashtu, numri i nxënësve të shkollave fillore, të cilët e pijnë duhanin dhe i kuptojnë këto efekte të dëmshme është më i vogël se sa i atyre të shkollave të mesme. Njëri prej faktorëve mund të jetë fakti se kjo temë diskutohet në plan-programin shkollor vetëm sa i përket promovimit dhe zhvillimit shëndetësor, si në shkollat fillore ashtu edhe në ato të mesme, mirpo kujdes i pamjaftueshëm i dedikohet pirjes së duhanit si qështje e veçantë, si dhe fakti se ekzistojnë pak materiale të mirëfillta dhe që i dedikohen të rinjve mbi pirjen e duhanit.

Duhanpirja pasive në Mjedis (DPM)

Gati të gjithë nxënësit, si të shkollave fillore ashtu edhe të shkollave të mesme, i ekspozohen tymit të duhanit si në shtëpi ashtu edhe në vende publike edhe pse ekspozimi ndaj tymit të dorës së dytë është më i lartë në shtëpi se sa në vende publike. Djemtë si dhe vajzat duket se i ekspozohen tymit të duhanit në masë të njëjtë. Edhe pse rezultatet na tregojnë se duhanpirësit aktual i ekspozohen tymit të duhanit në shtëpi në masë më të madhe se sa ata që nuk e kishin pirë kurrë duhanin, ajo se çka na brengos është se ekspozimi ndaj tymit të duhanit si rezultat i pirjes së duhanit nga ana e vëllezërve/motrave dhe shokëve/shoqeve në shtëpi është disa herë më i lartë për pirësit e tanishëm se sa për ata që kurrë nuk e kishin pirë duhanin. E gjithë kjo mund të jetë indikacion i tolerancës më të lartë në mesin e pirësve të tanishëm të duhanit (ndikimi i moshatarëve). Të dhënat gjithashtu tregojnë mungesë më të madhe të vlerësimit të efekteve të dëmshme, të duhanit të dorës së dytë në shëndet në mesin e nxënësve të shkollave të mesme të cilët e pijnë duhanin. Megjithatë, vetëm gjysma e nxënësve të shkollave fillore, të cilët janë pirës të duhanit, dhe pirësve të tanishëm të shkollave të mesme i pohon efektet e dëmshme të tymit të dorës së dytë, derisa vetëm 1/3 e nxënësve të shkollave fillore të cilët janë pirës të tanishëm të duhanit mendojnë se tymi i dorës së dytë është i dëmshëm për shëndetin e tyre.

Siç mund të parashikohej, një numër mjaft më i madh i nxënësve të cilët kurrë nuk e kishin pirë duhanin mendojnë se duhet të ndalohej pirja e duhanit në vende publike. Çuditërisht, numri më i vogël i nxënësve të cilët e përkrahin ndalimin e pirjes së duhanit në vende publike janë vajza. Një numër mjaft i madh i nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, të cilët kurrë nuk e kishin pirë duhanin e përkrahin ndalimin e pirjes së duhanit në vende publike. Është gjithashtu interesant fakti se vetëm pak më shumë se 1/3 e nxënësve të shkollave fillore, të cilët janë duhanpirës aktual, e përkrahin ndalimin e pirjes së duhanit në vende publike, në krahasim me mbi 3/4 e nxënësve të shkollave të mesme të cilët janë duhanpirës aktual

Dijenja dhe Qëndrimet

Adoleshentët zakonisht përqëndrohen në përfitimet afat-shkurtëra të pirjes së duhanit dhe nuk i japin rëndësi efekteve të dëmshme të duhanit. Për ta, pirja e duhanit është aktivitet shoqëror, mënyrë për të bërë kontakte me moshatar (duke i përfshirë edhe ata të gjinisë tjetër). Në të njëjtën kohë edhe mediat mund t'i formojnë qëndrimet e rinisë ndaj duhanit. Nxënësit, të cilët e shofin pirjen e duhanit si sjellje "normale" dhe i shofin gjërat të cilat mediat i promovojnë sitribute pozitive të duhanit dhe duhanpirjes janë të prirur për ta inicuar pirjen e duhanit.

Rezultatet e hulumtimit na tregojnë se duhanpirësit aktual si dhe ata të cilët kurrë nuk e kishin pirë duhanin mendojnë se pirja e duhanit iu sjell djemve dhe vajzave përparësi dhe i bënë më tërheqës. Numri i duhanpirësve aktual, të cilët kanë qëndrime të tilla është gati në të gjitha rastet më i lartë se sa i atyre të cilët kurrë nuk e kishin pirë duhanin. Të dhënat gjithashtu tregojnë se një numër më i madh i nxënësve të shkollave të mesme, si i duhanpirësve aktual ashtu edhe i atyre që kurrë nuk e kishin pirë duhanin, mendojnë se djemtë dhe vajzat të cilët e pijnë duhanin janë më tërheqës dhe kanë më tepër shokë/shoqe. Kjo tregon për ndikimin që porositë mediale e kanë mbi formimin e qëndrimeve të adoleshentëve mbi pirjen e duhanit, si dhe ndikimin të cilin moshatarët e grupeve të ndryshme ushtrojnë njëri mbi tjetrin në formimin e konsensusit në mes të adoleshentëve në lidhje me perceptimet e asaj se çka e bënë një individ të popullarizuar dhe si e vlerësojnë vetën.

Mediat dhe Reklamimi

Të dhënat flasin se edhe pse nxënësit e përfshirë në hulumtin raportuan se kishin parë porosi mediale kundër pirjes së duhanit, një numër më i madh kishte parë porosi mediale të cilat janë pro-duhanit. Dallimi statistikor në mes të djemve dhe vajzave të eksponuara me porosi mediale pro- dhe kundër duhanit nuk ishte i madh. Gjithashtu, nuk kishte dallim të madh në mes të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, me përjashtim të eksponimit me porosi të tilla nga radioja, gjë që mund të jetë indikator i asaj se nxënësit e shkollave të mesme e dëgjojnë dhe/ose i absorbojnë porositë nga radioja më shumë se sa nxënësit e shkollave fillore.

Ashtu siç ishte parashikuar, një numër mjaft i madh i duhanpirësve aktual posedojnë ndonjë gjë që mbanë logo të cigareve, por gjithashtu, një numri më të madh të tyre iu kishin ofruar cigare falas përfaqësues të ndonjë kompanie të duhanit. Edhe pse një numër më i vogël i djemve, të cilët kurrë nuk e kishin pirë duhanin, raportonin se nuk posedonin ndonjë gjë që mbanë logo të cigareve dhe se përfaqësues të ndonjë kompanie të duhanit nuk iu kishin ofruar cigare falas, gjasat që ata të posedojnë një gjë të tillë apo që t'iu ofrohen cigaret falas ishin më të mëdha se sa për vajzat të cilat kurrë nuk e kishin pirë duhanin. Kjo mund të jetë indikator i asaj se gjasat janë më të mëdha që djemtë t'i asociojnë qëndrimet dhe sjelljet e tilla me të qenë "maço" apo "cool" dhe që të sillen në mënyrë më të ngjajshme me moshatarët e tyre (si për ata janë duhanpirës aktual ashtu edhe për ata që kurrë nuk e kishin pirë duhanin).

Një e dhënë interesante tregon për një numër më të madh të nxënësve të shkollave të mesme, të cilët kurrë nuk e kishin pirë duhanin por që posedonin ndonjë gjë që mbante logo cigaresh dhe që janë në nivel të ngjajshëm me duhanpirësit aktual, si të shkollave fillore ashtu edhe të atyre të mesme. Në anën tjetër, nuk kishte dallim të madh statistikor në mes të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme që kurrë nuk e kishin pirë duhanin dhe pirës të tanishëm të duhanit sa i përket ofrimit të cigareve falas nga ndonjë përfaqësues i kompanive të duhanit.

Qasja dhe Dispozicioni

Të dhënat tregojnë se pak më shumë se 1/4 e pirësve të tanishëm të duhanit zakonisht e pijnë duhanin në shtëpi, që do të thotë se shumica e pijnë duhanin jashtë shtëpisë. Derisa më shumë se gjysma e duhanpirësve aktual blejnë cigare në dyqan një numër mjaftë i madh i tyre nuk i blenë në dyqan. Nuk kishte dallim të veçantë statistikor sa i përket gjinisë dhe nivelit shkollor. Një gjë që shkakton brengosje është numri shumë i madh i nxënësve, të cilët janë duhanpirës aktual, të cilët raportuan se nuk ju kishte refuzuar shitja e duhanit për shkak të moshës së tyre. Derisa nuk kishte dallim në mes të gjinive, të dhënat tregojnë se një numër mjaft i madh i nxënësve të shkollave fillore nuk kishin vështirësi për të blerë cigare në krahasim me nxënësit e shkollave të mesme. Siç duket, qasja e adoleshentëve të rinjë tek prodhimet e duhanit është kompletisht e pakufizuar.

Konkluzat dhe Rekomandimet

Në bazë të dhënave të fituara nëpërmjet GYTS në Kosovë, ekipi hulumtues konkludon se ekziston një rrezik i lartë për fillimin e pirjes së duhanit dhe potencialisht për rritjen e prevalencës së pirjes së duhanit te adoleshentët. Derisa nxënësve në shkolla iu ofrohen informata mbi pirjen e duhanit dhe shëndetin, të dhënat na sygjerojnë se strategjitë dhe programet shkollore mbi kontrollin e duhanit (si për ndalimin ashtu edhe për ndërprerjen e duhanpirjes) nuk janë efektive. Ka probabilitet të lartë sa i përket ritjes së barrës të sëmundjeve që kane të bëjnë me duhanin gjatë dekadave të ardhshme në Kosovë. Harxhimet e tanishme, në parandalimin efektiv, do të kursenin prej harxhimeve në të ardhmën mbi efektet e patologjive dhe mortalitetit të lidhur me duhanin.

Të dhënat gjithashtu tregojnë se adoleshentët të cilët e pijnë duhanin kanë dëshirë të madhe për ta ndërprerë, mirpo shkalla e dështimit është shumë e lartë. Kujdes i veçantë duhet t'i përkushtohet nevojave të pirësve të tanishëm për ta ndërprerë duhanin. Gjithmonë është e vështirë që të ndërpriten shprehinë varëse. Përdoruesit e duhanit shpeshë herë kanë nevojë të provojnë disa herë t'i ndërprejnë këto shprehi para se të janë të suksesshëm. Ata të cilët po provojnë kanë nevojë për shërbime efektive përkrahëse.

Reziqet e duhanpirjes pasive janë mirë të njohura. Të dhënat tregojnë se shëndeti i adoleshentëve në Kosovë, i atyre që janë duhanpirës aktual dhe atyre që kurrë nuk e kishin pirë duhanin, është i rrezikuar si pasojë e ekspozimit ndaj tymit të dorës së dytë si në shtëpi ashtu edhe në vende publike. Duhet t'i kushtojmë vëmendje rritjes së vetëdijes së prindërve mbi reziqet shëndetësore që ndërliken me duhanpirjen pasive në shtëpi. Gjithashtu ka nevojë për programe shkollore mbi duhanpirjen pasive dhe reziqet shëndetësore që shkaktohen nga pirja e duhanit nga ana e vëllezërve/motrave dhe shokëve/shoqeve. Duhet të promovohet dhe përkrahët advokimi nga ana e shoqatave profesionale dhe ushëheqësve të komuniteteve për ndalimin e pirjes së duhanit.

Rezultatet e GYTS tregojnë se nxënësit në Kosovë i ekspozohen dhe janë të vetëdijshëm për porositë mediale që janë pro-duhanit. Kjo ka një ndikim tepër të madh mbi qëndrimet dhe sjelljet e tyre. Rezultatet e hulumtimit gjithashtu konfirmojnë se qasja te duhani dhe dispozicioni i prodhimeve të duhanit në Kosovë për të rinjtë dhe adoleshentët është i pakufizuar. Tani nuk ka legjislacion apo rregullore në Kosovë mbi reklamimin e produkteve të duhanit në media. Derisa industria e duhanit i ka mjetet për të financuar fushata mediale pro-duhanit, mund të mirren masa nga autoritetet e Kosovës për ta kufizuar efektshmërinë dhe shtrirjen e tyre.

Rekomandimet për kontrollin e duhanpirjes:

- 1) Të zhvillohen programe kundër pirjes së duhanit të fokusuara mbi fëmijët para-shkollor dhe ata të shkollave fillore në mënyrë që të parandalohet fillimi i hershëm i duhanpirjes. Këto programe duhet ti kushtojnë vëmendje të posaçme tymit të duhanit në mjedis në mënyrë që t'i bëjë të vetëdijshëm adoleshentët, prindërit, motrat dhe vëllezërit, shokët/shoqet dhe farefisën për efektet e dëmshme të duhanit;
- 2) Aktivitete intenzive në shkolla për të themeluar norma kundër duhanpirjes, duke i përfshirë këtu materialet ndër-programore për punën kundër duhanpirjes dhe ndërprerjen e duhanpirjes për stafin arsimor dhe administrativ;
- 3) Edukimi nga ana e moshatarëve mund të luaj një rol të rëndësishëm në parandalimin e pirjes së duhanit pasi që ndikimi i moshatarëve është dominant në marrëdhëniet shoqërore të adoleshentëve. Një program mirë i trajnuar me bashkmoshtar mund të jetë veçanarisht i rëndësishëm dhe i qëlluar për të rinjtë;
- 4) Të implementohet një hulumtim kualitativ mbi efektshmërinë e programeve shkollore për kontrollin e duhanpirjes, aktiviteteve dhe dijenisë për duhanin, qëndrimeve dhe shprehive të rinjëve dhe adoleshentëve. Rezultatet e këtyre hulumtimeve mund të përdoren për ti korrigjuar programet ekzistuese shkollore dhe për të zhvilluar masa dhe strategji kontrolluese mbi duhanpirjen te të rinjtë;

- 5) Të përmirësohet efektshmëria e programeve për ndërprerjen e duhanpirjes të cilat janë miqësore ndaj të rinjëve me anë të themelimit të shërbimeve në shkolla për ndërprerjen e pirjes së duhanit. Ky program do duhej të jetë i modeluar për ti përmbushur dhe adresuar nevojat, interesat dhe prioritetet e 13-15 vjeçarëve;
- 6) Dhënia e përkrahjes për ndërprerjen e pirjes së duhanit nëpërmjet një varg të kanaleve miqësore për të rinjtë, siç janë klubet sportive, shoqatat dhe organizatat jo-qeveritare;
- 7) Të zhvillohen shërbime të cilat ofrojnë këshilla dhe aftësi profesionistëve arsimor dhe shëndetësor për ti përmbushur nevojat e përkrahjes;
- 8) Të forcohen dhe zgjërohen shërbimet për ndërprerjen e pirjes së duhanit nga të rriturit meqë parashikohet rritja e kërkesave me maturimin e këtij grupi;
- 9) Të forcohen masat ekzistuese mbrojtëse duke i rishqyrtuar ligjet dhe ndëshkimet ekzistuese për shkeljen e tyre dhe të zbatohet aplikimi i tyre;
- 10) Të ndalohet tërësisht reklamimi i produkteve të duhanit duke i përfshirë edhe ndodhitë e sponsoruara;
- 11) Të ndalohet shitja e produkteve të duhanit të gjithë atyre nën moshën 18 vjeçare dhe të zbatohet kjo ndalesë;
- 12) Të ndalohet duhanpirja në vende publike (duke filluar me institucione shëndetësore, shkolla, cilat do ndërtesa të cilat përdoren për aktivitete rinore dhe në aeroport, e më vonë të zgjërohet ndalimi edhe për restorante dhe kafene);
- 13) Të ndalohet marrja e donacioneve prej kompanive të duhanit nga ana e të gjitha ministrive apo organeve qeveritare, hapësirave shëndetësore dhe shkollave, organizatave apo organeve të cilat iu ofrojnë shërbime të rinjëve;
- 14) Të bëhet monitorimi i implementimit të legjislacionit dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me kontrollin e duhanit nga ana e ndonjë agjensionit apo trupi të pavarur dhe të publikohet raporti vjetor;
- 15) Të inicohet një fushatë për edukim dhe ngritje të vetëdijës, në mënyrë që të nënvizohen rreziqet që iu paraqiten fëmijëve të rinj në veçanti, si dhe të inkuadrohen fëmijët si avokues për një mënyrë të jetës pa duhan;
- 16) Të ketë programe arsimore dhe për sensibilizim për media në Kosovë mbi kontrollin e duhanit; dhe,
- 17) Shoqata Kosovare e Shëndetësisë Publike, në bashkëpunim me shoqatat tjera profesionale dhe Institutet për Shëndetësi Publike në mbarë Kosovën, duhet ta miratoj kontrollin e duhanit si program të rëndësishëm dhe të madh gjatë pesë viteve të ardhshme dhe të bëhen udhëheqës të avokimit mbi kontrollin e duhanit dhe vetëdijesimin e publikut.

Mirënjohjet

Ky hulumtin u përkrah financiarisht dhe teknikisht nga Shoqata Kanadeze për Shëndetësi Publike (CPHA) nëpërmjet një kontributi të dhënë nga Qeveria Kanadeze nëpërmjet Agjencionit Ndërkombëtar Kanadez për Zhvillim (CIDA) dhe Qendrave të SHBA-së për Kontrollim dhe Parandalim të Sëmundjeve (CDC). Ministria e Shëndetësisë dhe ajo për Arsim, Shkencë dhe Teknologji në Kosovë, gjithashtu e përkrahën këtë studim.

Dëshirojmë ti falënderojmë zotëri Jim Chauvin (Kordinator Rajonal për Evropën Jug-Lindore, Shoqata Kanadeze për Shëndetësi Publike) dhe Zotëri Mike Parry (Drejtor i Projektit, Projekti Rajonal për Shëndetësi Publike në Ballkan (Shoqata Kanadeze për Shëndetësi Publike) për përkrahjen që i dhanë implementimit të projektit, analizës dhe kryerjes së raportit final. Dëshirojmë ta falënderojnë Dr. Charles W. Warren (Ekspert i Dalluar i Statistikës, Zyra e CDC-së Mbi Pirjen e Duhanit dhe Shëndetin) për kontributin e tij profesional gjatë gjithë hulumtimit dhe analizës, si dhe për ndihmën e tij gjatë kryerjes së raportit final. Mirënjohjet tona gjithashtu ia drejtojmë Zonjës Juliette Lee dhe Zonjës Veronica Lea (Epidemiologe, Zyra e CDC-së Mbi Pirjen e Duhanit dhe Shëndetin) dhe të gjithë kolegëve në CDC për ndihmën e tyre.

Gjithashtu dëshirojmë të falënderojmë Akademinë Mjekësore të Kosovës, Shoqatën e Mjekëve të Kosovës, Shoqatën për Shëndetësi Publike të Kosovës, Drejtorin e Institutit për Shëndetësi Publike, për përkrahjen që ia dhanë punës sonë, si dhe kolegëve tanë nga Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe Instituti për Shëndetësi Publike në Mitrovicë, dhe kolegëve në UNICEF/Kosovë për pjesëmarrjen e tyre aktive në këte projekt. Mirënjohja jonë gjithashtu i drejtohet punonjësve të sektorit arsimor dhe të rinjëve Kosovar për pjesëmarrjen e tyre aktive në këtë hulumtim.

BIBLIOGRAFIA

- i The World Bank. Curbing the Epidemic: Government and the Economics of Tobacco Control. The World Bank: 1999, Washington D.C.
- ii Gajalakshmi C., Jha P., Ranson K., Nguyen S. Global patterns of smoking and smoking-attributable mortality in: Tobacco control in developing countries, Oxford University Press:2000, New York.
- iii Mackay, J., Eriksen, M. The Tobacco Atlas, WHO: 2000, Geneva.
- iv World Health Organization. European Strategy for Tobacco Control. WHO Regional Office for Europe: 2000, Copenhagen.
- v Mackay, J., Eriksen, M. The Tobacco Atlas, WHO: 2000, Geneva.
- vi Glanz S. Tobacco Biology and Politics, University of California Press: 1999.
- vii Centres for Disease Control and Prevention, Targeting Tobacco use: The Nation's Leading Cause of Death, At a Glance 2003, www.cdc.gov/nccdphp/aag/aag_osh.htm
- viii American Heart Association. Heart and Stroke Statistics-Update, 2003
- ix Ramadani N.: Tobacco as a dominant risk factor in lung cancer in Kosova. 12th World Conference on Tobacco or Health, 3-8 August 2003, Helsinki
- x UNICEF Kosovo. Youth in Kosovo: Health, Education, Employment and Participation, a survey conducted by Index Kosova, Jun 2004.